




Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja (d), nenit 14, nenit 17 paragrafi 1 shkronja (c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr-03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 30/2013"), Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) 01 Nr. 2566 i datës 30.05.2013, nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 39, nenit 40, nenit 57 paragrafi 1 pika 1.3 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit me Nr. Prot. 1005 të datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 29/06/2022, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e lokacionit për ndërtimin e morgut për nevojat e komunitetit të fshatit Hoçë e Vogël

1. Me këtë vendim **caktohet** lokacioni për ndërtimin e morgut për nevojat e komunitetit të fshatit Hoçë e Vogël dhe më gjerë.
2. Lokacioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi do të jetë në pjesën e parcelës kadastrale sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71510046-00813-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 35595m² (tridhjetë e pesë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e pesë metra katror), zona kadastrale Hoçë e Vogël, e evidentuar në posedim të Komuna e Rahovecit.
3. Nga sipërfaqja e përgjithshme e parcelës së cekur në nenin 2 të këtij vendimi, ndahen **500m² (pesëqind metra katror)** për ndërtimin e morgut për nevojat e komunitetit të fshatit Hoçë e Vogël dhe më gjerë.
4. Pjesa e parcelës në sipërfaqe prej 500m² (pesëqind metra katror) në të cilën parashihet të ndërtohet morgu për nevojat e komunitetit të fshatit sipas pikës 1 dhe 2 të këtij vendimi, sipas Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) 01 Nr. 2566 i datës 30.05.2013 gjendet brenda zonës ndërtimore.
5. Morgu i cili do të ndërtohet për nevojat e komunitetit të fshatit Hoçë e Vogël do të financohet nga donatorët.
6. Prona e paluajtshme dhe objekti që do të ndërtohet nuk e ndërron titullarin juridik, pronar i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë nga donatorët e ndërtimit të objektivit.
7. Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit që të bëjë parcelizimin dhe skicimin në teren dhe regjistrimin e gjendjes në librat kadastral.

8. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
9. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Anëtarëve të Kuvendit ,*
- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, dhe*
- *Arkivi.*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr-349/22
Me datë 29.06.2022


Dejran Kafexhiu
Kryesues i Kuvendit